




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.470/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković - Kryetar, z . Nuhi Paçarizi- Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Telekomi i Kosovës” shpk Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e telefonisë Mobile për Komunën dhe Institucione tjera Komunale” me nr. të prokurimit: 19-4916-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/–Komuna Mitrovicë , më datën: 27.08.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Telekomi i Kosovës” shpk Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e telefonisë Mobile për Komunën dhe Institucione tjera Komunale” me nr. të prokurimit: 19-4916-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues–Komuna Mitrovicë .

**II. ANULOHET**, aktiviteti i prokurimit me titull: “Shërbimet e telefonisë Mobile për Komunën dhe Institucione tjera Komunale” me nr. të prokurimit: 19-4916-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ –Komuna Mitrovicë.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV .**Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Telekomi i Kosovës” shpk - Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 15.07.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 29.07.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 29.07.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 22.07.2019.

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 25.07.2019.

Operatori ekonomik ankues “Telekomi i Kosovës” shpk Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 01.08.2019 me nr. 470/19, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e telefonisë Mobile për Komunën dhe Institucione tjera Komunale” me nr. të prokurimit: 19-4916-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna Mitrovicë /KKM/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 9.4, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.08.2019, ka autorizuar ekspertin profesionale të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt: 15.08.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si ne vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Telekomi i Kosovës sh.a” – Prishtinë.

### SQARIM HYRËS

1. OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim me dt: 22.07.2019.
2. AK ka kthye përgjigjeje me dt: 25.07.2019.
3. Afati i fundit për dërgimin e ankesës në OSHP ka qenë deri me dt: 04.08.2019.
4. Hapja e ofertave me dt: 29.07.2019.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Pretendimi i parë i OE ankues është se Ligji për prokurim Publik gjegjësisht neni 9 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim: “autoriteti kontraktues kur është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për të siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”. Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur autoriteti Kontraktues ( Autoriteti Publik ) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik, për me tepër është interpretimi i KRPP-së ku thekson se një autoritet kontraktues publik nuk ka nevojë të procedoj ndonjë procedurë të prokurimit përderisa një shërbim ofrohet nga një autoritet tjetër kontraktues publik.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne nenin 9 paragrafi 4 te LPP-së ku thotë:

9.4. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t’u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne sqarimet me lart konstaton se AK nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 9.4 te LPP-së duke filluar me publikimin këtij aktiviteti te prokurimit.

Gjithashtu eksperti shqyrtues duke u bazuar ne interpretimin e KRPP-së ku thotë:

Citati:

36. Duke marr për bazë dilemat e shfaqura të Autoriteteve Kontraktuese dhe , kërkesat e shumta të tyre (drejtuar KRPP-ës ) që të bëhet e qartë se si duhet të veprohet në rastet kur një Autoritet Kontraktues ( Autoritet Publik ) ka nevojë për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik?

Konform nenit 87, paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim:

Sa i përket çështjes se parashtruar më lartë, Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim:

“Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për tu siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”.

Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik ) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik.

LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritetet publike do të rregullojë plotësimin e nevojave të tyre ( në mes vete ) meqë kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera.

Mirëpo është më se e qartë se këto raste kanë të bëjë me përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet ( një AK mund e kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tije ose shërbimeve të një autoriteti tjetër kontraktues pa iniciuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim “ në shtëpi ).

Si përfundim pas analizimit të cekur me lartë ( neni 9.4 të LPP-së ) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-së e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar “shërbimin e konkurrencës” ( sikur ato nga direktiva e BE-së, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është e vendosur në nenin 9.4 të LPP-së.

*KRPP, nuk do të publikojë asnjë lloj Njoftimi ( Njoftimi për kontratë, Njoftimin për dhënie apo për nënshkrimin e kontratës ) dhe do të deklarojë aktivitetet, vendimet dhe/ose kontratat jo ligjore në rast se nuk janë respektuar dispozitat e cekura me lartë apo cila do dispozitë tjetër e legjislacionit për prokurim publik.*

Eksperti shqyrtues sqaron se ne rastin konkret KRPP ka bërë publikimin e aktivitetit ne fjalë duke rënë në kundërshtim me interpretimin e lëshuar po ashtu nga vetë KRPP, ku në paragrafin e fundit te këtij interpretimi thotë:

*Citoj: KRPP, nuk do të publikojë asnjë lloj Njoftimi ( Njoftimi për kontratë, Njoftimin për dhënie apo për nënshkrimin e kontratës ) dhe do të deklarojë aktivitetet, vendimet dhe/ose kontratat jo ligjore në rast se nuk janë respektuar dispozitat e cekura me lartë apo cila do dispozitë tjetër e legjislacionit për prokurim publik.*

Prandaj nga kjo qe u tha me lartë del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, dhe rekomandon që të anulohet njoftimi për kontratë.

Operatori ekonomik "Telekomi i Kosovës" shpk Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 16.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertës shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues Komuna Mitrovicë , përmes parashtresës me shkrim të datës: 15.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me mendimin e ekspertës shqyrtues .

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.08.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së dhe ekspertja profesionale e prokurimit ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Prebreza deklaroj: Ne qëndrojmë pranë ankesës që kemi parashtruar, dhe bazuar ne pretendimet ankimore Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e LPP-së bazuar ne raportin e ekspertës shqyrtuese të prokurimit bazuar në vendimet e OSHP-së në lidhje me pretendimet e njëjta propozojmë që të anulohet vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesit të AK-së z. Ferati deklaroj: Ne si Autoriteti Kontraktues e kemi zbatuar plotësisht ligjin e LPP-së duke e zbatuar LPP-në dhe nenet nenin 1, 6, 7 të cilat janë nene që ligji i prokurimit parasheh që të siguroj mënyrën efikase transparente dhe të drejtës se shfrytëzimit të fondeve publike, neni 6 Ekonomiciteti dhe efikasiteti, trajtimi ne mënyrë të barabartë dhe jo diskriminues dhe neni 7 barazia ne trajtim dhe jo diskriminim.

Së pari theksoj që OE fare nuk ka marre pjesë ne procedurën e prokurimit në fjale me është kërkuar edhe nga zyrtaret e OSHP-së me shkrim se pse ju ka pranuar ankesa e OE kur nuk ka marr pjese dhe ju kam përgjigjur se Autoriteti Kontraktues nuk ka marr kurrfarë Ofertë gjatë procedurës së prokurimit nga Telekomi i Kosovës në këtë procedure ka marr pjese vetëm IPKO.

E dyta sa i përket nenit 9 pika 4 ku bazohet telekomi thuhet shume mire ne si Autoriteti Kontraktues ju kemi përgjigjur ne këtë mënyrë Telekomit: Citoj" nëse Autoriteti Kontraktues është autoritet publik duhet të merr masa të arsyeshme nuk do të thotë që është obligative për tu siguruar që lendet që i përmbushin

këto nevoja janë ne dispozicion nga një tjetër Autoritet tjetër publik që do të thotë që këto shërbime nuk i ofron vetëm Telekomit” AK KK-Mitrovicë nuk ka obligime ndaj Telekomit, sikur se ekzistojnë kompani publike që i themelon komuna për këto kompani publike dhe këto shërbime mund e quhen shërbime ne shtëpi.

Ne si Autoriteti Kontraktues cekim se ka shume kompani publike të cilat kishin mundur ti marrin shërbimet por nuk jemi të obliguar, psh: Ujësjetësi në Mitrovicë është kompani publike dhe ne gjithherë shpallim tender.

Jemi plotësisht të bindur se kemi zbatuar ligjet e LPP-së dhe kërkojmë nga paneli që të aprovoj vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe procedura të vijoj me tutje.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja profesionale e prokurimit znj. Beka deklaroj: Kërkesën për rishqyrtim e ka bërë para hapjes gjë që llogaritet pale e interesit. Sqarimet tjera i kam dhënë sipas ligjit 9.4 te LPP-së dhe interpretimin e KRPP-së, që në duhet ti respektojmë dhe sipas sqarimeve ne raportin e datës 15.08.2019 qëndroj prapa raportit tim në ekspertize.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklaramit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se Komisioni Rregullativ Për Prokurim Publik ka lëshuar një interpretim në lidhje me pretendimin e OE ankues për mosrespektim të nenit 9.4 të LPP-së, nga autoritetet kontraktuese ku ka sqaruar si në vijim: “Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t’u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”. Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik. LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do te rregullojnë plotësimin e nevojave te tyre ( ne mes vete) meqë kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera. Mirëpo është më se e qartë se këto raste kanë të bëjnë me përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tij ose shërbimeve te një autoriteti tjetër kontraktues pa iniciuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim “blerje në shtëpi”). Si përfundim pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar “shtrembërimin e konkurrencës” (sikur ato nga direktiva e

BE-ës, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 të LPP-së”.

Paneli shqyrtues duke pasur parasysh faktin që Telekom i Kosovës është autoritet publik dhe ofron shërbime profesionale të natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit, dhe duke pasur parasysh faktin që AK KK Mitrovicë si autoritet kontraktues nuk e ka respektuar nenin 9.4 të LPP-së, atëherë ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet dhe të merret për bazë neni 9.4 i LPP-së.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se parashtruesi i ankesës “Telekomi i Kosovës” sha, ankesës i ka bashkangjitur kopjen e shkresës, “Marrëveshje mbi shfrytëzimin e kontratës publike kornizë për ofrimin e shërbimeve Telekomunikuese të lidhur me Ministrin e Administratës Publike (MAP) dhe Telekom i Kosovës”sha, me nr. prok: 202-16-102-215”, ku objekt i marrëveshjes është ofrimi i shërbimeve të përshkruara si: Shërbimet - Telefonike mobile, internet, internet për GPRS, kabli optik, shërbimet e telefonisë fikse, shërbimet e TV –kabllovik”. Sipas përshkrimit, marrëveshja e njëjtë ka kohëzgjatje prej 36 muajve, përkatësisht nga data 01.04.2017, deri më datën 31.03.2020, Andaj duke u nisur nga ky fakt paneli shqyrtues sqaron se, nëse Telekom i Kosovës nëse nuk arrin ta përmbush kontratën e cekur si më lart sipas kushteve dhe kriterëve të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktues, atëherë, autoriteti kontraktues mund ta shkëputë kontratën me këtë operator ekonomik sipas kushteve të parapara të kontratës ekzistuese dhe se marrëdhëniet e tyre kontraktuale palët ti rregullojnë nëpërmjet gjykatës kompetente sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore apo edhe ligjeve tjera në fuqi.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK- Komuna Mitrovicë

1x1 OE-“ Telekom i Kosovës”Sh.A - Prishtinë.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.